# TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

| Prokurimi Publik<br>CELEX 32014L0024 , Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, 28.03.2014, DIRECTIVE 2014/24/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 February 2014 on public procurement and repealing Directive 2004/18/EC , Official Journal of the European Union, L 94/65. | | | **PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9643, DATË 20.11.2006, "PËR PROKURIMIN PUBLIK", TË NDRYSHUAR**<br>Përputhshmëri e plotë | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëri a** | **Shënime** |
| 57<br>Kriteret e skualifikimit | Paragrafi 1:<br><br>Autoritetet kontraktore skualifikojnë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit kur ata kanë përcaktuar, duke verifikuar në përputhje me nenet 59, 60 dhe 61, ose janë vënë në dijeni në mënyra të tjera se operatori ekonomik ka marrë një dënim me një vendimi të formës së prerë për një nga arsyet e mëposhtme:<br><br>(a) pjesëmarrje në organizatë kriminale, siç përcaktohet në nenin 2 të Vendimit Kuadër t | | 1 | Në nenin 45 "**Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve"**, bëhen ndryshimet si më poshtë:<br><br>**1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:**<br><br>"1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Këshillit 2008/841/DPB ;<br><br>(b) korrupsioni, siç përkufizohet në nenin 3 të Konventës për luftën kundër korrupsionit ku janë përfshirë zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe në nenin 2 paragrafi 1 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2003/568/DPB , si dhe korrupsioni siç përkufizohet në legjislacionin e brendshëm të autoritetit kontraktor ose të operatorit ekonomik;<br><br>(c) mashtrimi sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane ;<br><br>(d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, siç përcaktohet përkatësisht në nenet 1 dhe 3 të Vendimit Kuadër të | | | përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, kur ka të dhëna se është ose ka qënë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për ndonjë nga veprat e mëposhtme:<br><br>a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;<br><br>b) korrupsion | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Këshillit 2002/475/ÇBD ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale, siç përmenden në nenin 4 të këtij Vendimi Kuadër;<br><br>(e) pastrim parash ose financim i terrorizmit, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ([37]);<br><br>(f) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në nenin 2 të Direktivës 2011/36/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ([38]);<br><br>Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij operatori ekonomik ose ka kompetenca përfaqësuese, | | | ;<br><br>c) mashtrim;<br><br>d) pastrim parash, ose financim i terrorizmit;<br><br>e) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda atij operatori ekonomik. | | | f) organizimi, drejtimi ose financimi i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;<br>g) falsifikim;<br>puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik, zbatohet edhe kur | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksioner ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij. | | |
| | | | | | | |